



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, palët i dorëzuan parashtrime me shkrim Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me pikat faktike për të cilat pajtohen. Gjykatësi i kishte urdhëruar t'i bënin parashtrimet në përputhje me Rregulloren, sipas së cilës ai duhet të evidentojë pikat për të cilat Prokuroria dhe Mbrojtja pajtohen, për të përshpejtuar procesin duke shkurtuar listën e pikave të kontestuara.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 18 nëntor, Prokurori i Specializuar dorëzoi një listë paraprake me 40 dëshmitarët e parë që Prokuroria synon të thërrasë gjatë gjykimit.

Dje, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi pjesërisht kërkesat e Thaçit dhe Selimit për leje për apelimin e dy vendimeve të mëparshme të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ku autorizonte Prokurorin të ndryshonte listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale.

Në vendimet e nxjerra më 18 nëntor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Jakup Krasniqi dhe z. Rexhep Selimi. Gjykatësi konstatoi se për të dy të akuzuarit ekziston ende rrezik i moderuar që të arratisen, të pengojnë procesin gjyqësor apo të kryejnë krime të tjera dhe këto rreziqe nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm nga kushtet jashtë objektit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara. Gjithashtu, Gjykatësi vlerësoi proporcionalitetin e përgjithshëm të kohës në paraburgim dhe konstatoi se për asnjë nga të akuzuarit nuk është joproporcionale.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, Trupi Gjykues urdhëroi vazhdimin e paraburgimit pasi konstatoi se ekziston ende rreziku që z. Mustafa të pengojë ecurinë e procesit çka nuk mund të zvogëlohet mjaftueshëm me kushte apo kufizime shtesë. Gjithashtu, Trupi Gjykues konstatoi se z. Mustafa nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme.

Të enjten dhe të premten e javës së ardhshme, më 1 dhe 2 dhjetor është caktuar një seancë apeli në çështjen gjyqësore *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*. Sipas rendit të ditës të caktuar nga Paneli i Apelit më 1 dhjetor, secilit ekip do t'i jepet mundësia të paraqesë gojarisht argumentet në mbështetje të apelit. Më 2 dhjetor, do t'i jepet mundësia Prokurorisë të përgjigjet dhe ekipeve të Mbrojtjes të kundërpërgjigjen. Gjithashtu, z. Gucati dhe z. Haradinaj, nëse dëshirojnë, mund t'i drejtohen personalisht Panelit të Apelit.

Publiku mund të përcjellë seancën më 1 dhe 2 dhjetor nga galeria e publikut të DHSK-së ose përmes faqes zyrtare të Dhomave të Specializuara, në shqipe, serbishte ose anglishte.





Kërkesa e parashtruar më parë nga z. Haradinaj për caktimin e një seancë në këtë çështje, tashmë ka dalë në version të redaktuar publik dhe gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Këtë javë përfaqësues të Dhomave të Specializuara organizuan aktiviteve ndërvepruese me të rinj dhe përfaqësues të shoqërisë civile në zonën e Gjilanit, Prishtinë dhe në Shterpçë.

Ndër lajme të tjera: Aleks Uajting mori funksionin e ushtruesit të detyrës së Prokurorit të Specializuar, pas largimit të Xhek Smith si Prokurori i Përgjithshëm më 18 nëntor. Z. Uajting do të jetë ushtrues i detyrës së Prokurorit të Specializuar deri në emërimin e Prokurorit të Ri të Specializuar në bazë të Ligjit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

